



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e martë, në datën 02 shkurt 2021, në mjediset e AMA-s, u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Gentian	SALA	Kryetar
Sami	NEZAJ	Zëvendëskryetar
Agron	GJEKMARKAJ	Anëtar
Gledis	GJIPALI	Anëtar
Suela	MUSTA	Anëtar

AMA në këtë mbledhje shqyrtoi vendimin e KQZ “Për Miratimin e Metodologjisë së Monitorimit të medias audio dhe audiovizive” dhe ra dakord të njoftohet KQZ mbi pamundësinë e zbatimit të disa parashikimeve të këtij akti.

AMA në këtë mbledhje mori në shqyrtim relacionet dhe projektvendimet për heqjen/konstatimin e pavlefshmërisë së licencës/autorizimit të subjekteve debitorë ndaj AMA-s dhe/ose Buxhetit të Shtetit për vitin 2020, dhe ra dakord që këto subjekte të njoftohen për të fundit herë për shlyerjen e detyrimeve financiare.

AMA pasi shqyrtoi çështjet e rendit të ditës, vendosi:

1. Çeljen e procedurës së lëshimit të një licencë shërbimi programi audioviziv në qarqet Tiranë dhe Durrës”. (**Vendimi nr. 9, datë 02.02.2021**)
2. Zgjerimin e zonës së licencimit të shoqërisë “Media Neë Vizion” sh.p.k., licencuar për subjektin “Radio 1”, për të mbuluar me sinjal audio “*Bashkitë Elbasan, Cërrik dhe Belsh*”. (**Vendimi nr. 10, datë 02.02.2021**)

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 02.02.2021